



Institucioni : Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave

Duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L – 149 dhe Rregulloren Nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave shpall konkurs për këtë pozitë:

KONKURS

Titulli i punës : Zyrtar Ligjor 2

Nr.ref. RP00082006

Kategoria funksionale : Niveli Profesional

Koeficienti : 7

Lloji i pozitës : I karrierës

Orët e punës : 40 orë në javë

Kohëzgjatja e emërimit: 1 vitë periudha provuese

Vendi i punës : Prishtinë

Mbikëqyrës: Drejtori të Departamentit Ligjor/Licencim

Qëllimi i vendit të punës: Ofrimi i shërbimeve dhe këshillave profesionale në fushën e hartimit të politikave dhe legjislacionit nga fushëveprimi i institucionit

Detyrat Kryesore

- Përgatitja e draft rregulloreve dhe udhëzimeve sipas nevojave të ARH-s, bazuar në Rregulloret dhe Direktivat e BE-se;
- Kujdeset që përmbajtja dhe forma e projekt akteve normative të jetë e saktë, si nga aspekti gjuhësor dhe teknik si dhe të jenë identike në gjuhët zyrtare;
- Ndhmon në përgatitjen e opinione ligjore si dhe hartimin e projekt marrëveshjeve, projektvendimeve dhe projekt akteve të tjera;
- Bashkëpunon me njësitë tjera brenda ARH-s për aktivitetet që ndërlidhen me fushën e legjislacionit;
- Përgatitja e politikave rreth aspekteve të ndryshme të rregullimit të transportit hekurudhor;
- Përgatitja e shkresave të ndryshme ligjore dhe draft vendimeve që i ndërmerr ARH-ja si dhe shkresave tjera që ndërlidhen me ARH-në;
- Përgatitja e shkresave administrativo-juridike për gjykata si dhe përfaqësimi i ARH-se në kontestet gjyqësore sipas autorizimit;
- Kryen dhe pune të tjera që i caktohen nga mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë.

Shkathtësitë e kërkuara

- Diplomë universitare, Fakulteti Juridik , Bachelor/Jurist i Diplomuar
- 2 vite përvojë pune profesionale
- Njohuri të thellë dhe të specializuar në fushën e legjislacionit dhe hartimin e akteve ligjore;
- Njohuri të ligjeve dhe rregulloreve të aplikueshme;
- Shkathtësi në komunikim planifikim të punës koordinimi eventual i personelit në nivel administrativ;
- Shkathtësi hulumtuese, analitike, vlerësuese dhe formulim të rekomandimeve dhe këshillave profesionale;
- Shkathtësi kompjuterike në aplikacione të programeve (Word, Excel, Power Point, Access);

Marrja dhe dorëzimi i aplikacioneve:

Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyrat e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, Adresa: Rr. Rrustem Statovci Nr 29 Prishtinë, çdo ditë pune nga ora 08:00 deri 16:00. Aplikacioni mund të shkarkohet edhe në ueb faqen zyrtare www.arh-ks.org

Konkursi është i hapur 15 ditë kalendarike nga data e publikimit të shpalljes së konkursit.

Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për këtë vend pune, për të cilin konkurren.

“Shërbimi civil i Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë.”

“Komunitetet jo-shumicë dhe pjesëtarët e tyre kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil të administratës publike qendrore dhe lokale siç specifikohet në Nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës”.

“Aplikacionet e dorëzuara pas afatit të paraparë nuk pranohen dhe aplikacionet e mangëta refuzohen”. Aplikacionit i bashkëngjiten kopjet e dokumentacionit mbi kualifikimin, përvojën dhe dokumentacionet e tjera të nevojshme, që kërkohen për atë vend pune për të cilin konkurren. Vetëm kandidatët e përzgjedhur në listën e shkurtër do të kontaktohen.